

## KONTRATE PER KALIM KUOTE

Sot me date 02.02.2022, ne Tirane, palet e kesaj kontrate per kalimin e kuotes ("Kontrata"), rane dakord si me poshte vijon:

1. **Z. Idajet ISMAILAJ**, shtetas shqiptar, i biri i Sadik dhe Qazime, lindur më 22.01.1963, në Siqecë, Fier, banues në Tiranë, me numër personal identifikimi G301220100, (ketu e ne vijim «**Z. Ismailaj**»).

dhe

2. Shoqeria "**MOTUS**" sh.p.k me seli ne adresen Sheshi Italia, Arena Center, Seksioni D, Kati 5, Tirane, person juridik regjistruar me NIPT M02404024C, perfaqesuar me Vendim nr.4, date 02/02/2022 te Ortakut te Vetem nga Administratori i shoqerise **Z.Elton HOXHA**, identifikuar me Nr.Personal I10806167M, (ketu e ne vijim «**MOTUS**»).

MOTUS Shpk dhe Z.Ismailaj jane referuar me poshte individualisht si "**Pala**" dhe se bashku si "**Palet**".

### DEKLARATA PARAPRAKE:

- I. Z.Idajet Ismailaj eshte ortak i 1 (nje) kuote te barabarte me 50.730.000 (pesedhete milion e shtateqind e tridhete mije) Leke, qe perfaqeson 57% (pesedhete e shtate perqind) te kapitalit te shoqerise **FINMAN Sh.p.k.**, shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, regjistruar prane QKB-se, me NUIS L62405030K, me seli ne Sheshi Italia, Arena Komercale, Seksioni D, Kati i 5<sup>te</sup>, Tiranë ("**Shoqeria**");
- II. Kapitali i Shoqerise eshte 89,000,000 (tetedhete e nente milion) Leke;
- III. Z.Idajet Ismailaj ka qellim t'i kaloje shoqerise MOTUS Shpk kuoten qe zoteron ne Shoqerine FINMAN Shpk, te barabarte me 50.730.000 (pesedhete milion e shtateqind e tridhete mije) Leke e cila perben 57% (pesedhete e shtate perqind) te kapitalit te Shoqerise ("**Kuota**");
- IV. Me ane te Vendimit nr.3, date 02/02/2022 te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve te FINMAN Shpk eshte autorizuar kalimi i Kuotes nga Z. Idajet Ismailaj tek shoqeria Motus Shpk, e cila me Vendimin e Ortakut te Vetem nr.4, dt.02/02/2022 ka pranuar pronesine e Kuotes, dhe ne perputhje me Statutin e Shoqerise dhe sipas dispozitave te Ligjit Nr.9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", i ndryshuar ("**Ligji Tregtar**") Kuota mund te transferohet pa pengese nga pronesia e Z.Idajet Ismailaj ne pronesine e Motus Shpk.



PER KETO ARSYE, Palet bien dakord si me poshte:


1. Z.Idajet Ismailaj i kalon ketu shoqerise MOTUS Shpk Kuoten e sipercituar, ne castin e nenshkrimet te kesaj Kontrate.
2. Shoqeria Motus Shpk pranon pronesine e kesaj Kuote dhe pranon te gjitha te drejtat dhe detyrimet qe lidhen me pronesine e kesaj Kuote sipas parashikimeve te Statutit te Shoqerise dhe Ligjit Tregtar.
3. Z.Idajet Ismailaj dhe Motus Shpk bien dakord qe me kerkesen e pare te Pales tjeter dhe/ose Shoqerise, te nenshkruajne dhe te leshojne cdo dokument te nevojshem dhe ne pergjithesi te bejne cdo gje qe eshte e nevojshme qe transferimi i pronesise mbi Kuoten sipas kesaj Kontrate, te regjistrohet prane QKB-se, si edhe prane cdo autoriteti tjeter shqiptar, sipas ligjit.

Kjo Kontrate u hartua ne 3 (tri) kopje origjinale me vlere te njejte, ne gjuhen shqipe.

PALET

Per MOTUS Sh.p.k.

Z. Elton Hoxha

  
Administrator

Z. Idajet ISMAILAJ

  
\_\_\_\_\_

